Kronikë

Detaje të reja nga shpërthimi me tritol në zyrën e noterit Fran Gjoni në Lezhë! Autorët e hodhën nga makina në ecje, ishin maskuar si të moshuar

Detaje të reja janë zbuluar nga tritoli i cili u vendos noterisë së Fran Gjonit në Lezhë. Autorët e dyshuar kanë udhëtuar me një automjet tip BMW të aksidentuar shumë kohë e pa përdorur dhe në këtë situatë u përdor me targa të vjedhura.



Zjarr e noterit, pas shpërthimit me tritol, 26 shkurt

Elvis Hila
28 Shkurt, 13:05 | **Përditesimi: 28 Shkurt, 14:05**

Share

LEZHË-Detaje të reja janë zbuluar nga tritoli i cili u vendos noterisë së Fran Gjonit më 26 shkurt në Lezhë. Burime bëjnë me dije se janë të përfshirë dy autorë, të cilët kanë përdorur tritol me fitil që e kanë hedhur direkt nga makina.Gjithashtu raportohet se ata ishin maskuar ku shfaqeshin si të moshuar.

Nga pamjet e sigurisë shihen dy persona ku njëri prej tyre ka qenë në rolin e shoferit ndërsa tjetri ka kryer hedhjen e tritolit tek shkallët para noterisë.

Autorët e dyshuar kanë udhëtuar me një automjet tip BMW të aksidentuar shumë kohë e pa përdorur dhe me targa të vjedhura. Po ashtu dyshohet se ata kanë dalë jashtë Lezhës.

[Sh].com

LEXO EDHE:
Vrau 67-vjeçarin në Kurbin për motive pronësie, autori pranon fajin: E qëllova me armë, jam penduar! Lihet në burg

Kur ndodhi shpërthimi

Shpërthimi ndodhi rreth orës 4:00 të mëngjesit të së mërkurës, por fatmirësisht nuk pati persona të lënduar, por vetëm dëme materiale.

Në dëshminë e tij paraprake në polici, Fran Gjoni ka deklaruar se nuk kishte konflikte.

Grupi hetimor po mbledh çdo provë dhe dëshmi dhe pista me qëllim zbardhjen e ngjarjes, ndërsa pista kryesore e hetimeve është përqendruar tek veprimtaria e noterit i cili operon prej më shumë se 1 dekade në qytetin e Lezhës.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: shperthim me tritol | gjin gjoni | fran gjoni | Lezhe

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Mandarina me pesticide, sa të sigurta janë produktet që konsumojmë?

27 Shkurt, 09:24

Shumë | Pak | Aspak

Lajme të tjera

Gjergj Kastrioti 'rikthehet' në shtëpi! Shtatorja e heroit kombëtar vendoset përballë memorialit në Lezhë
Elvis Hila
27 Shkurt, 10:44

Rruga përmbytej nga shirat, nis ndërhyrja tek Ura e Cenit në Lezhë, investimi 22 milionë lekë
Elvis Hila
26 Shkurt, 17:04

Vrasja e Ardian Nikulajt, shtyhet gjyqi për portugezin Ruben Saraiva! Priti një orë në korridore, masa të forta sigurie, mungoi përkthyesja
Elvis Hila
26 Shkurt, 14:41

Simon Hadaj: Të korruptuar e të inkriminuar, mblidhuni te Berisha!
Simon Hadaj
26 Shkurt, 13:59

Primareve të Berishës i bashkohet edhe gjenerali Gjunkshi, i dha Malltezit klubin 'Partizani'! Në garë për deputet edhe ish-prokurori Ndoja, iu bë atentat në makinë me 'Rrumin e Shijakut'
26 Shkurt, 10:52

Shpërthim me tritol në zyrën e noterit Fran Gjoni në Lezhë, vëllai i ish-gjyqtarit sheik Gjoni! Dy autorët e pamaskuar hodhën lëndën plasëse (VIDEO)
26 Shkurt, 06:56

Vrasja e 67-vjeçarit dje në Kurbin/ Arrestohet autori, u prangos me armën e zjarrit me vete! Policia: Krimi ndodhi për motive pronësie (EMRI)
Elvis Hila
25 Shkurt, 16:35

Kurbin/ Drogë, armë dhe detonatorë, 'Hideout' prangos 2 vëllezërit e dyshuar! Sekuestrohen 10 kg hashash (EMRAT+VIDEO)
25 Shkurt, 13:27

Vrasja dje në Kurbin, viktima u qëllua 6 herë me pistoletë, 10 të shoqëruar! Pista e hetimit, hakmarrja dhe konflikti për pronën
Elvis Hila
25 Shkurt, 10:07

Gjykata Europiane shqyrton sot planet e Italisë për transferimin e refugjatëve në Shqipëri
25 Shkurt, 08:29

Kurbin/ Po punonte në pyll, 67-vjeçari vritet me 3 plumba në fshatin Vilëz, dyshohet për konflikt pronësie (EMRI)
24 Shkurt, 18:18

Ish-gjyqtari sheik Gjin Gjoni i bëhet 'pullë poste' Berishës edhe në Parma! Kreu i PD kërkon votën e Diasporës për të mundur Ramën, sulmon Soros e McGonigal (VIDEO)
22 Shkurt, 17:07

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje